



Të mbrojmë mjedisin për të ardhmen tonë dhe vendin ku jetojmë!

Rrethanat dhe mjedisi ndikojnë mbi ne, por ne jemi përgjegjës për vetveten.

Paulo Coelho

Në këtë buletin do të gjeni:

Raporti i Gjendjes në Mjedis për vitin 2020

Fushata e sensibilizimit “Thuaj Jo ndotjes, përdor më pak plastikë”

Faqe 1

Inspektimet e operatorëve në kuadër të mbrojtjes së mjedisit

Vlerësimi i gjendjes së ujërave bregdetare të largjes

Faqe 3

Roli i konsultimit me publikun në vendimmarrjen mjedisore

Përfshirja e Shqipërisë në aktivitetet e Agjencisë Europiane të Mjedisit

Faqe 2

Hartimi i Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit

Faqe 4

Rubrika

“Mesazhe Ndërgjegjësuese”

Faqe 4

Raporti i Gjendjes në Mjedis për vitin 2020

Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka publikuar Raportin e Gjendjes në Mjedis për vitin 2020. Ky raport paraqet vlerësimin e gjendjes së mjedisit bazuar në të dhëna përkatëse për komponentët kryesor të mjedisit si pyjet, biodiversiteti, burimet ujore, ajri, menaxhimi i mbetjeve, toka, zhurmat dhe ndotja industriale.

Raporti i Gjendjes në Mjedis, informon dhe njeh publikun mbi gjendjen e treguesve mjedisore, ndikimin në shëndet e mjedis si dhe tendencën e tyre ndër vite. Gjithashtu ndihmon politikëbërësit të ndërmarrin veprime për të mbrojtur dhe menaxhuar mjedisin.



Qëllimi kryesor i vlerësimit të gjendjes së mjedisit është që të kuptohen pasojat ose ndikimet në mjedis që vijnë nga sektorë të ndryshëm dhe të identifikojë mënyrat për të minimizuar ndikimet negative.

Paraqitja e RGJM për vitin 2020 është bazuar mbi kërkesat e raportimit të Agjencisë Europiane të Mjedisit, kjo me qëllim që të kemi një botim në përputhje me metodologjinë e përcaktuar.

Nëpërmjet publikimit të këtij dokumenti, shpresojmë që të merret informacion sa më gjithëpërfshirës për mjedisin dhe të shërbejë si një bazë e mirë për ndërgjegjësimin e publikut në mbrojtje të mjedisit. Gjithashtu të ndihmojë në hartimin e politikave më efikase jo vetëm në përmirësimin e gjendjes së mjedisit, por edhe në parandalimin e ndikimeve në mjedis.

Raporti i Gjendjes në Mjedis për vitin 2020 është publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit www.akm.gov.al.

Fushata e sensibilizimit “Thuaj Jo ndotjes, përdor më pak plastikë”

Spektori i Performancës dhe Objektivave Mjedisore në Drejtorinë e Performancës Mjedisore, në kuadër të një nga sfidave më të mëdha që po përballon sot e gjithë bota, ndotja nga mbetjet plastike dhe mbeturinat e hedhura në det, me fillimin e sezonit turistik ka ndërmarrë fushatën e sensibilizimit përgjatë bregdetit shqiptar #ThuajJONdotjes, përdor më pak plastikë”.

Synimi ynë ka qenë ndërgjegjësimi i qytetarëve, turistëve për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe vecanërisht menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Ndarja e mbetjeve në burim, hedhja e tyre në vend depozitimet e caktuara dhe ruajtja e mjedisit detar nga mbetjet dhe plastika shmangin ndikimin negativ në biodiversitet dhe shëndetin tonë.



Mbetjet me përmbajtje plastike, alumini, qelqi, mbetjet ushqimore të hedhura në natyrë dhe në mjediset ujore çlirojnë kimikate, të cilat paraqesin rrezikshmëri të lartë duke ndikuar gjithashtu edhe në ndryshimet klimatike. Plastika ka veti që është lehtësisht e transportueshme në ujë në mënyrë të vazhdueshme, duke e bërë atë ndotës në mjedisin ujor dhe bartës i kësaj ndotjeje në organizmat e pranishëm në ujë.



Përvetësimi i mikroplastikës nga një gamë e gjerë e specieve ujore prish funksionet e tyre fiziologjike të cilat më pas me anë të zinxhirit ushqimor shkaktojnë probleme shëndetsore të njerëzimit.

Hedhja e pakontrolluar e mbetjeve është një shqetësim global pasi plastikës i duhet rreth 500 vite që të dekompozohet në ujë dhe deri në 1000 vite që të dekompozohet në tokë, kanaceve të aluminit u duhen rreth 200-500 vite për tu dekompozuar.

Niveli më i lartë i ndotjes nga alumini është 1,300 gram dioksid karboni për një kanaçe 330 ml, ekuivalent me ndotjen që shkakton një makinë gjatë një distancë prej 7-8 km. Shishet e qelqit duan deri në 1 milion vite të dekompozohen. Kur letra kalbet, lëshon gaz metani që është 25 herë më toksik sesa CO2.

Për të mbrojtur mjedisin dhe shëndetin Thuaj JO Ndotjes, shmangies së përdorimit të pipëzave, lugëve, pirunjve, pjatave plastike njëpërdorimshme të cilat mund të zëvendësohen me produkte që mund të ripërdoren ose riciklohen. ♻️

Roli i konsultimit me publikun në vendimmarrjen mjedisore

Për periudhën Maj-Gusht, 2021, janë marrë në shqyrtim dhe janë dhënë vendime për 400 projekte, që i nënshtrohen procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Pjesën më të madhe të aplikimeve e zënë projektet infrastrukturore, të enteve publike dhe private.

- Ndër projektet publike mund të përmendim:
 - Rikonstrukcione linjash elektrike, rrugësh, urash, ujesjellës.
 - Blloqe banimi për familjet e pastreha.
- Ndër projektet private përmendim:
 - Projektet në fushën e turizmit dhe agroturizmit.
 - Projekte infrastrukturore.

E gjithë procedura është ndjekur në zbatim të:

- Ligjit 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar
- Ligjit Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”

Një rol të rëndësishëm në këtë proces luan edhe procedura e konsultimit me publikun në vendimmarrjen mjedisore, e cila kryhet për projektet në fushën e energjitikës dhe për procesin e thelluar të VNM-së, në bazë të VKM 247/2014.



Qëllimi kryesor i këtij procesi, është të sigurojë:


- a) një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim;
- b) garantimin e një procesi të hapur vendimmarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis, në mënyrën dhe kohën e duhur; si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të.

Përfshirja e Shqipërisë në aktivitetet e Agjencisë Europiane të Mjedisit

Bashkëpunimi ndërinstitucional mes Agjencisë Europiane të Mjedisit (AEM) dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për periudhën Maj- Gusht 2021 ka vijuar në përmbushje të detyrimeve raportuese të Shqipërisë drejt AEM sipas afateve të përcaktuara, nga NRC (National Reference Centre) e nominuara për secilën tematikë mjedisore, që ata mbulojnë.

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve dhe me mbështetjen e instrumentit IPA, në muajin Maj filloi një cikël intensiv trajnimesh nga ekspertet më të mirë të EEA me ekspertë shqiptar të institucioneve kombëtare monitoruese, kryesisht të fushës së ujërave, me qëllim përmirësimin e ekspertizës në fushën e monitorimit dhe raportimeve mjedisore si në nivel kombëtar ashtu dhe në nivel ndërkombëtar dhe në përputhje të plotë me kerkesat aktuale të direktivave dhe standarteve europiane.

Kjo paketë mbështetje ishte në kuadër të projektit “Forcimi i pjesëmarrjes së vendeve të Ballkanit Perëndimor në punën dhe aktivitetet e Agjencisë Europiane të Mjedisit për periudhën 2020-2021” ku, aktivitetet e planifikuara përfshijnë fushën e ujërave dhe vlerësimit të pritshmërive mjedisore në të ardhmen.




Në të u përfshinë mbi 15 ekspertë kombëtarë të shpërndarë sipas fushave të tyre të ekspertizës në një total prej 9 cikle trajnimesh. Në muajin shtator fillon cikli dytë i këtij procesi.

Gjatë këtyre muajve është finalizuar edhe struktura e re e EIONET të Agjencisë Europiane të Mjedisit, pjesë e së cilës është edhe Shqipëria. Kjo strukturë është punuar nga një grup pune me përfaqësues të disa vendeve, ku përfaqësues nga Ballkani Perëndimor ishte Shqipëria. Struktura e re e EIONET/EEA do të miratohet në 16 shtator 2021 në Bordin Menaxhues të Agjencisë Europiane të Mjedisit, ku do të marrë pjesë edhe AKM.

Pas këtij procesi do të fillojë faza e implementimit të saj nga gjithë vendet anëtare të AEM dhe EIONET, përfshirë edhe Shqipërinë.

Inspektimet e operatorëve në kuadër të mbrojtjes së mjedisit

Drejtorja e Inspektim- Kontrollit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për periudhën Qershor-Korrik ka inspektuar operatorë që përfshihen në industrinë minerare si “miniera nëntokësore dhe veprimtaritë e lidhura me to, nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe impiante franksionimit të gurit gëlqeror, impiante asfalto-betoni etj”.



Gjatë inspektimeve nga Drejtorja e Inspektim - Kontrollit janë konstatuar parregullësi dhe shkelje të kërkesave të legjislacionit mjedisor në fuqi, konkretisht mos zbatimin e parimeve dhe kërkesave në ligjin Nr. 10 448 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ligjin Nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, ligjit Nr. 10 431, datë 9.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, VKM-ve respektive etj.

Për konstatimet e bëra nga ana e grupeve të punës, për gjetjet dhe shkeljet e kërkesave ligjore operatorët janë sensibilizuar në zbatimin e saktë të legjislacionit mjedisor në fuqi.

Drejtorja Inspektim Kontrollit do të vazhdojë të ushtrojë detyrat e saj funksionale për të garantuar zbatimet e kushteve të Lejes Mjedisore.

Veprimtaritë dhe numri i inspektimeve paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Veprimtaria	Numri i inspektimeve të kryera
1	Miniera nëntokësore dhe veprimtaritë lidhur me to”	2
2	Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur”	9
3	Impiante asfalto-betoni	16
4	Prodhimi i produkteve abrazive dhe produkteve të tjera minerale jometalike	27
5	Veprimtaritë që nuk përfshihen në pikat 7.3 a ose 7.3 b ose në pika të tjera të kësaj shtojce, që përfshijnë ngrohjen, por jo distilimin e katanit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari prodhimi	10
6	Menaxhimi i mbetjeve	3
7	Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to	4
8	Prodhimi i eksplozivëve	1
9	Prodhimi i produkteve të përbëra tërësisht apo kryesisht nga druri nëse veprimtaria përfshin: sharrimin, shpimin, fërkimin me rërë, gdhendjen, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit	
10	Trajtim me regjie dhe prodhimi i lëkurës	1


Vlerësimi i gjendjes së ujërave bregdetare të larjes

Agjencia Kombëtare e Mjedisit nëpërmjet Institutit të Shëndetit Publik është duke kryer monitorimin mikrobiologjik të ujërave bregdetare të larjes në plazhet e Velipojës, Shëngjinit, Tales, Durrësit, Gjiri i Lalzit, Kavajës, Divjakës, Semanit, Vlorës, Palasës, Dhërmiut, Jalës, Himarës, Qeparoit, Borshit, Ksamilit, Sarandës, Lukovës, Pogradecit, Linit, për vitin 2021.

Bazuar mbi konkluzionet e raportit teknik të pjesshëm, për monitorimin mikrobiologjik të ujërave bregdetare të larjes për periudhën 15 Maj-1 Gusht, të dërguar nga Instituti i Shëndetit Publik pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit rezultojnë se:


Para fillimit të sezonit turistik vihej re një cilësi shumë e mirë e tyre përsa i përket monitorimit nga ana mikrobiologjike.

Nga monitorimi mikrobiologjik i kryer gjatë vijimit të sezonit turistik rezultojnë se cilësia e ujërave bregdetare pothuajse në të gjitha pikat e monitorimit paraqitet me një cilësi shumë të mirë.



Disa pika monitorimi kanë paraqitur ndotje të lartë mikrobike, konkretisht 2 pika monitorimi në plazhin e Durrësit, 1 pikë monitorimi në plazhin e Vlorës dhe 2 pika monitorimi në plazhin e Pogradecit (Liqeni i Ohrit).

Faktori kryesor i ndotjes së ujrave të larjes mbeten shkarkimet e ujrave urbane të pa trajtuara në ujrat pritëse bregdetare në mënyrë direkte dhe indirekte, të cilat shkaktojnë ndotje të këtyre ujrave.



Në pikat e monitorimit të ndotura gjatë inspektimi higjieno-sanitar u konstatua prani e shkarkimeve të ujrave urbane të pa trajtuara në ujrat pritëse në mënyrë direkte.

Nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit është kryer informimi i bashkive respektive për pikat e monitorimit të ndotura dhe janë dhënë rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

Hartimi i Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit



Sektori Kërkimit, Analizës dhe Bashkëpunimit Shkencor në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, ka hartuar draft Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit për vitin 2022.

Ky program përgatitet duke u bazuar në VKM Nr 1189 datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit.

Programi kombëtar i monitorimit të mjedisit përcakton treguesit kryesorë të gjendjes, të ndikimit dhe të trysnisë në ajër, në ujëra sipërfaqësore e nëntokësore, në tokë, në zonën bregdetare, në detet, pyjet e në larminë biologjike.

Programi pas miratimit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, publikohet në variantin elektronik në faqen zyrtare të AKM dhe shërben si bazë për kërkesat e institucioneve monitoruese për të paraqitur projektet, me ofertat e tyre.

Institucionet monitoruese, në bazë të programit, japin me hollësi dhe hartojnë projekte të veçanta për monitorimin e treguesve mjedisorë, të marrë përsipër prej tyre. Këto projekte shërbejnë si bazë për konkurimin dhe për lidhjen e kontratave të monitorimit.

Monitorimi mjedisor vlerëson kushtet dhe tendencat mjedisore, i cili mbështetet në zhvillimin e politikave dhe zbatimin e tyre, sigurimin e informacionit për raportimin tek politikëbërësit kombëtarë, forumet ndërkombëtare dhe publikun.

Institucionet monitoruese të cilat përfshijnë institutet, laboratorët e qendrat kërkimore-shkencore, universitetet

publike, institutet e laboratorët private të liçensuar, kontraktohen nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Për realizimin e monitorimit të treguesve konkrete të dukurive natyrore, të cilësisë së përbërësve të mjedisit si ajri uji, toka dhe biodiversiteti, institucionet duhet të përdorin metoda të validuara dhe të akredituara, të cilat përfshijnë metodat e matjes në vendin e marrjes së mostrës, shpeshinë e njësive të matjes, mënyrën e përcaktimit, përpunimit e paraqitjes së të dhënave.

Gjithashtu në këtë program përfshihen tregues të rinj për monitorimin e mjedisit, të cilët përdoren nga Agjencia Europiane e Mjedisit.

Qëllimi është që të arrihet një përsosje e procesit të monitorimit të mjedisit dhe për të përmbushur detyrimet kombëtare dhe ndërkombëtare të raportimit për gjendjen e mjedisit.

Rubrika

“ Mesazhe Ndërgjegjëse ”

Ndotja e ajrit!

Ndotja e ajrit urban shkakton efekte negative për shëndetin e njerëzve dhe ekosistemet mjedisore. Shkarkimet nga automjetet, transporti, sektori i ndërtimit si dhe shkarkimet industriale kanë kontributin kryesor në ndotjen e ajrit. Llojet e grimcave ndotëse, gazrat toksike dhe ndotësit e tjerë të çliruar nga aktivitete të ndryshme njerëzore, ndikojnë në ajrin e pastër. Ndotja e ajrit vjen edhe si pasojë e një perzierje komplekse me shumë komponentë toksik që rrjedhin nga djegia e lëndëve djegëse për transportin apo edhe përdorimit të lëndës djegëse në shtëpi.



Ndotësit kryesorë të ajrit

Grimcat e pluhurit me diametër më të vogël se 10 µm (PM 10) dhe 2.5 µm (PM 2.5)

NO₂, NO, CO₂, CO, SO₂, O₃, BTEX, etj


Metale të rënda (Pb, Cd, Zn, Cu etj)

Efektet në shëndetin e njerëzve

Ndotësit që prekin më shumë njerëzit janë grimcat e pluhurit me madhësi 10 µm dhe 2.5 µm.

Reagimet ndaj ndotësve të ajrit ndryshojnë në varësi të shkallës së ekspozimit, gjendjes shëndetësore si dhe faktorit gjenetik të personit. Efektet shëndetësore të ndotjes së ajrit janë serioze. Ndikon në sistemin nervor, shkakton kancer të mushkërive,

sëmundje të zemrës, sëmundje respiratore, Po ashtu mund të shkaktojë dhimbje koke, marramendje, ankth dhe lodhje.



Si mund të ndihmojmë të gjithë?

Përdorni sa më pak automjetet private për të mundësuar lehtësim të trafikut urban si dhe reduktimin e ndotjes së ajrit nga shkarkimet dhe pluhuri që shkaktojnë. Zbatimi i kërkesave mjedisore nga sektori i ndërtimit dhe industrial për parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes. Uljen e përdorimit të lëndës djegëse në shtëpitë tona duke përdorur burime të tjera ekologjike. Shtimi i gjelbërimit në mjediset ku jetoni për një ajër të pastër dhe trup të shëndetshëm.

Ndotja Akustike!



Ndotja akustike është çdo lloj ndotje e shkaktuar nga zhurma e cila arrin shkallën mbi 85 decibel (dB), mund të ketë pasoja afatgjata tek shëndeti i njeriut dhe rrit mundësinë për të pësuar dëmtime në dëgjim

Ndikimet në shëndetin e njerëzve

Ndotja akustike në nivel të lartë mund të shkaktojë humbjen e dëgjimit qoftë për një kohë të shkurtër apo edhe për tërë jetën. Zhurmat e padëshirueshme rritin presionin, shkaktojnë lodhje, ulin gjumin, rritin stresin dhe pengojnë përqëndrimin. Shkaktojnë probleme psikologjike (agresivitet, padurueshmëri) dhe frenim në shpejtësinë e komunikimit. Sjellin ndryshime në sistemin hormonal dhe imunitar si dhe ndikojnë negativisht në aparatit tretës

Burimet kryesore të zhurmave urbane janë:

- Trafiku urban
- Trafiku rrugor
- Trafiku hekurudhor
- Industria (zhurmat profesionale dhe mjedisore)
- Tregëtia (zhurmat profesionale dhe mjedisore)
- Ndërtimi dhe zhurma në godinat e shërbimit.
- Aktivitete argëtuese ku përfshihen; koncertet e hapura, diskoteka, lokale, dite apo nate ku luhet muzikë e lartë.

Si mund të mbrohemi?

Pas një qëndrimi në ambient me nivel të lartë zhurme duhet kaluar në një ambient larg zhurmave. Një nga masat më ekonomiqësore për të reduktuar nivelin e ndotjes është sigurimi i hapësirave të mbjella me pemë midis zonave të banuara dhe rrugës kryesore.

Në industri duhet të ketë program mbrojtës ndaj zhurmës, të përdorin tapa veshi, kufje gjatë punës, dhe të përcaktohen vendet e pushimit pa zhurmë.

Të bëhet izolimi i makinave që prodhojnë zhurmë dhe ripërtëritja e teknologjisë në vazhdim.


Për trafikun duhet që sipërfaqja e rrugës të shtrohet me material që zbut rrugën (asfalt poroz).

Të zbatohen kriteret në ndërtim, larg qendrave të banuara, me amortizim të mirë me orare të përcaktuara.

Dita ndërkombëtare pa çanta plastike (3 Korrik)

Kjo ditë është një mundësi për ndërgjegjësimin e publikut për mos përdorimin e çantave plastike duke patur parasysh rrezikun dhe ndikimin e tyre në mjedis. Ekzistojnë shumë mundësi të tjera mjedisore të përdorimit të çantave që nxitin zhvillimin e qendrueshëm.

Përdorimi i tepërt, pa kontroll, hedhja e tyre vend e pa vend, mos dërgimi për riciklim paraqet probleme serioze për mjedisin ku jetojmë. Qeset plastike përdoren për një mesatare prej 12 minutash dhe pasi hidhen, kërkojnë 100-1000 vjet për t'u dekompozuar. Në mbarë botën, vetëm 9% e tyre riciklohet, ndërsa 73% e mbeturinave të detit janë plastike.



Në vitin 2017, Tirana është përfshirë në nismën për zvogëlimin e përdorimit të çantave plastike, përmes vendosjes së pagesës për çdo çantë plastike të përdorur.

Të dashur qytetarë të vendit tonë, dashamirës të mjedisit ku jetojmë dhe veprojmë, ju ftojme të zëvendësoni përdorimin e tyre me materiale të tjera më miqësore me mjedisin (trasta pëlhure etj).

Të pakësosh volumin e mbeturinave ke pakësuar ndotësit!



Zjarret, armiku kryesor i pyjeve

Arsyet e rënies së zjarreve në pyje janë nga më të ndryshmet.

Në Shqipëri rastet e rënies së zjarreve në mënyrë natyrale (rrufe, kontrak elektrik, etj.) janë shumë të rralla. Ndërsa rënia e zjarreve në pyje/kullota ku shkaktar është njeriu, ndodh kryesisht nga: **pakujdesia, padituria, piromania apo dhe me vetëdije të plotë.**



1.Zjarret e shkaktuara nga pakujdesia apo padituria përfshijnë kryesisht zjarret e shkaktuara nga njerëzit që punojnë në pyje apo kullota të cilët kryejnë punime operationale në këto sipërfaqe.

2.Zjarret e qëllimshme vendosen me arsyen që të zgjerojnë tokën e punueshme apo kullotat, për shkak të konflikteve të pronësisë mbi pyjet dhe kullotat, konfliktet midis barinjve për të drejtat e përdorimit apo pronësisë mbi kullotat, përfshirë këtu edhe mentalitetin e barinjve për ripërtëritjen e bimësisë barishtore nëpërmjet djegies së asaj egzistuese, për përfitim të druve të zjarrit apo materialit për ndërtim, për të mbuluar prerjet ilegale, etj.

3.Ndër shkaqet e tjera të zjarreve në pyje mund të përmendim edhe faktorin klimatik pasi nën kushtet e ndryshimit të klimës, thatësira mund të shkaktojë regjime të ashpra të zjarreve në aspektin e numrit dhe shtrirjes së tyre.



Faktorët që ndikojnë në përhapjen e zjarreve.

Temperaturat e larta, lagështia relative dhe shpejtësia e erës, janë gjithashtu parametra të rëndësishëm që ndikojnë në përhapjen e zjarreve. Sipërfaqja pyjore e prekur nga zjarret ndikohet edhe nga faktorë të tillë si: lloji i bimësisë, topografia, stina, të cilët sipas rastit mund t'a rrisin apo reduktojnë ndikimin e zjarreve në ekosistemet pyjore.

Dëmet që shkaktajnë zjarret.

Përveç humbjes së materialit drusor, erozioni është fenomeni i parë që shfaqet në tokat e zhveshura dhe që ndihmohet nga era. Shtresa e kores së tokës pëson gjithashtu djegie dhe kjo përkthehet në humbje të lëndëve organike për bimët e mbetura ose ato të reja, prishje të ekuilibrave hidrikë (modifikim të përbërjes dhe lagështisë së bimësisë në tokë), prishjen e habitateve të kafshëve të egra, degradim të peizazhit natyror, dhe pa dyshim sëmundje, insektet, era dhe ngricat.

Për të shmangur zjarret këshillohet:

- ✚ Mos hidhni cigaret e ndezura në mjedise të hapura.
- ✚ Mos digjni bimësitë dhe plehërat në ambiente të hapura në mjedise urbane, apo në sipërfaqet e punueshme në afërsi të pyjeve
- ✚ Shmangni punimet në ambiente të hapura pasi ato mund të shkaktojnë zjarr.
- ✚ Mos ndizni zjarre në mjedise të hapura në afërsi të pyllit, apo në afërsi të barit dhe degëve të thata.
- ✚ Hidhni mbeturinat në vendin e duhur dhe mos i lini në pyll, sepse ekziston mundësia e vetëndejesjes.
- ✚ Shmangni pirjen e duhanit gjatë kohës së të mbjellave.
- ✚ Dhe më kryesorja, **mos ndizni zjarre në Pyje në mënyrë të qëllimshme.** Për këtë kategori njerëzish, duhet të ketë sanksione të forta dhe të qarta sipas ligjeve në fuqi

